Data: 10 Shtator 2019

## Njoftim

# Nga data 1 Tetor 2019, furnizimi i barnave me recetë në kuadër të Fondit do të realizohet vetëm me recetë dhe letër njoftimi/pasaportë

**Personat e siguruar, nga data 1 Tetor i vitit 2019 do të kenë mundësinë të furnizohen me barna me recetë vetëm me anë të recetës dhe dokumentit për identifikim (letrës së njoftimit ose pasaportës).**

**Deri në këtë datë ( 1 Tetor 2019) , gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore në kuadër të Fondit në fuqi do të jenë rregulloret me anë të së cilave, përshkrimi i barnave tek mjeku amë si dhe procedura gjatë dhënies së barit në barnatore realizohet me anë të librezës shëndetësore bashkë me dokumentin e identifikimit të personit të siguruar (letrës së njoftimit ose pasaportës).**

**Fondi për sigurim shëndetësor si blerës i shërbimeve shëndetësore është konstruktiv dhe i hapur për bashkëpunim me të gjitha palët që e përbëjnë sistemin shëndetësor dhe punon për implementimin e zgjidhjeve të shërbimeve elektronike të mundshme me anë të së cilave do të lehtësohet puna administrative e institucioneve shëndetësore gjatë përshkrimit dhe dhënies së barnave me recetë, në qëllim që shërbimi shëndetësor të jetë më efikas dhe më i arritshëm për personat e siguruar.**

Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија
Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Адреса: Ул. Македонија, бр. 5, 1000 Скопје
Adresa: Rr. Maqedonia, nr. 5, 1000 Shkup

Тел/Tel: 02/3289-000
Факс/Faks: 02/3289-048
e-mail: info@fzo.org.mk
www.fzo.org.mk